



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

	Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	
	KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA KOSOVO JUDICIAL COUNCIL	
Nr. Et. No.	01 / 1532	
Dat. Dt.	14. 11. 2022	
	PRISHTINË - A	

PËR: Ilmi Bajrami, Mbikëqyrës i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme
PREJ: Muhamet Rexha, Kryetar i Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore
LËNDA: Përgjigje
DATA: 11.11.2022

I nderuar gjyqtar Mbikëqyrës Bajrami,

Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, ka pranuar kërkesën tuaj të datës 10 tetor 2022, për dhënie të opinionit Këshillëdhënës, lidhur me efektin që shkakton në aspektin kohor për palët ushtrimi i vonuar i kompetencave të administrimit të lëndëve, sipas nenit 22, të Ligjit për DHPGJS, me numër 06/L-086, gjegjësisht nëse gjyqtari përgjegjës i lëndës mundë të bëjë ndarjen e padisë/ankesës grupore pas nëntë (9) vitesh nga koha e regjistrimit të saj.

Ju bëjmë me dije se bazuar në nenin 1,7 dhe 9, të Rregullores Nr.01/2022, për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, Komiteti ka shqyrtuar kërkesën tuaj në takimet e mbajtura me datë 09 dhe 11.11.2022. Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, KKEGJ ka ardhur në përfundim se të gjitha çështjet e ngritura nga ana juaj, janë trajtuar nga Komiteti i Etikës në Opinionin Këshillëdhënës KKEGJ.nr.01/2022, të datës 13.04.2022, i cili për objekt shqyrtimi ka pasur temën: “Standardet etike të zbatueshme, në rastin e barazisë së palëve, trajtimit të lëndëve gjyqësore sipas prioritetit dhe radhës së regjistrimit të tyre në gjykatë”, i cili është publikuar në web faqen e KGJK-së.

Në lidhje me çështjen e ngritur nga ana juaj, në pikën V të këtij opinionit këshillëdhënës, janë dhënë konkluzionet përfundimtare, ku ndër të tjera konstatohet se: “Gjyqtarët duhet ti trajtojnë lëndët sipas radhës dhe kronologjisë kohore të regjistrimit të tyre në gjykatë. Respektimi i këtij parimi, siguron në mënyrë efektive trajtimin e barabartë të palëve në procedure gjyqësore, përfshirë këtu edhe aspektin kohor të dhënies së drejtësisë së kërkuar...”. Ndërsa pjesët tjera të konkluzioneve përcaktojnë detyrimet e gjyqtarëve në respektimin e rregullave të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, në raport me respektimin e parimit për trajtim të barabartë të palëve, por edhe përgjegjësitë dhe veprimet të cilat duhet të ndërmerren menaxhmenti i gjykatës nëse konstatohen shkelje të këtij parimi nga ana e gjyqtarëve.

Meqenëse, KKEGJ-it i ka rezultuar se për çështjen etike të ngritur nga ana juaj veç është dhënë paraprakisht një opinion këshillëdhënës, rrjedhimisht edhe ka ardhur në përfundim se nuk është e nevojshme që për të njëjtën çështje të jap opinion të ri. Sidoqoftë, KKEGJ e vlerëson lartë kontributin tuaj profesional për çështjen etike të ngritur, si dhe ju inkurajon juve dhe gjyqtarët tjerë që për të gjitha dilemat rreth shkeljeve të mundshme të Kodit të Etikës, ti drejtoheni Komitetit.

Ju falënderojmë paraprakisht për bashkëpunim!